



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Këtë javë Mbrojtja e Hashim Thaçit filloi paraqitjen e provave të saj me thirrjen e dëshmitarëve në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Të hënën, më 15 shtator, filloi dhënien e dëshmisë Xhejms Rubin, dëshmitari i parë i thirrur nga Mbrojtja. Z. Rubin vazhdoi dëshminë të martën dhe të mërkurën, kur iu bënë pyetje nga Mbrojtja dhe nga Prokuroria. Gjykatësit e Trupit Gjykues gjithashtu i bënë pyetje dëshmitarit. Të mërkurën, dëshmitari i dytë, Pol Uilliams filloi dhënien e dëshmisë, e cila përfundojë sot.

Seancat në gjykim janë caktuar për të hënën, martën dhe të mërkurën e ardhshme.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 11 shtator, Trupi Gjykues miratoi një kërkesë të Mbrojtjes së Thaçit për ndryshim të listës së provave materiale, duke shtuar aty katër dokumente në lidhje me dy dëshmitarë. Në një tjetër vendim, më 12 shtator, Trupi Gjykues miratoi një kërkesë të Mbrojtjes së Thaçit për pranimin e disa materialeve si prova. Trupi Gjykues informoi gjithashtu se disa nga materialet e paraqitura për pranim do t'i shqyrtojnë në një vendim më vete që lidhet me kërkesat sipas rregullës 154. Rregulla 154 i mundëson një pale pranimin si provë të deklaratës me shkrim të një dëshmitari, në vend të marrjes në pyetje drejtpërdrejt në sallë të gjyqit.

Më 16 shtator, Trupi Gjykues miratoi një mocion të Mbrojtjes së Viktimave, që i kërkonte gjykatës të bënte konstatim gjyqësor të disa fakteve të shqyrtuara në çështjen gjyqësore të Pjetër Shalës për krime lufte, të cilat Mbrojtja e Viktimave i gjykonte relevante për dëmin e shkaktuar ndaj viktimave pjesëmarrëse në çështjen gjyqësore të zotërinjve Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi.

Në shtojcën e vendimit jepen hollësi në lidhje me faktet për dëmin që pësuan viktimat që u mbajtën në fabrikën e metalit në Kukës, në Shqipërinë veriore në 1999. Për shembull, të gjithë të ndaluarit në njërin prej dhomave u keqtrajtuan fizikisht dhe psikologjikisht çdo ditë nga një numër anëtarësh të UÇK-së, u detyruan të shihnin dhe dëgjonin keqtrajtimet fizike të të ndaluarve të tjerë dhe u kërcënuan me dhunë ose vdekje.

Ndër faktet e shqyrtuara në çështjen e Pjetër Shalës përfshihet edhe fakti se të ndaluarit në fabrikën e metalit në Kukës pësuan lëndime afatgjata fizike dhe mendore, si: lëndime në kokë, djegie, bërryl të thyer, dhëmbë të thyer, dhimbje të madhe të vazhdueshme në trup, ndjenjat e turpit, frikës dhe cenueshmërisë, dhe çrregullim të stresit pastraumatik, përsirë makthe, fanitje dhe kujtime të pavullnetshme.

Sipas Rregullores, Trupi Gjykues në një çështje, kur është në interes të kryerjes së shpejtë dhe të drejtë të gjyimit, mund të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera të Dhomave të





Specializuara ose në procese të përfunduara në gjykata të tjera në Kosovë, ose në sisteme gjyqësore të tjera, që kanë lidhje me aspekte që po shqyrtohen në procesin aktual, për sa kohë që ato nuk kanë të bëjnë me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarve të paraqitura në Aktakuzë.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit lidhur me pretendime për vepra penale për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, Gjykatësja e Procedurës Paraprake njoftoi këtë javë se synon t'ia kalojë çështjen trupit gjykues në gjysmën e parë të nëntorit 2025, në varësi të vendimeve që do të jepen nga Paneli i Gjykatës së Apelit. Gjykatësja ftoi gjithashtu pesë ekipet e Mbrojtjes që të dorëzojnë dosjet paraprake deri më 20 tetor 2025. Në një vendim të mëhershëm, Prokurorisë iu caktua data 19 shtator si afat për të dorëzuar dosjen gjyqësore paraprake dhe listën e dëshmitarëve.

Në të njëjtën çështje, më 15 shtator, Gjykatësja e Procedurës Paraprake miratoi një kërkesë të Mbrojtjes së Thaçit për t'i dhënë Trupit Gjykues në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte, të gjithë dëshmitarët që po japin dëshmi në të dy çështjet. Kjo do të ndihmonte Mbrojtjen e Thaçit në përgatitjen e një kërkesë për disa ndryshime në protokollin e kontaktit me dëshmitarë, gjë që do të ndihmojë Mbrojtjen në kryerjen e hetimeve të saj. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vuri në dukje se Prokuroria nuk e kundërshtoi kërkesën dhe se dhënia e informacionit nuk bënte të nevojshme heqjen e masave mbrojtëse për dëshmitarët.

Më 12 shtator, Gjykatësja e Procedurës Paraprake miratoi një kërkesë për të autorizuar krijimin e kopjes forenzike të telefonit mobil që iu sekuestrua Hajredin Kuçit në mars 2024 dhe të raportit përkatës, për t'ia dorëzuar atë kopje Mbrojtjes së z. Kuçi.

